| 46 | 021421 | PNS-Kategoria I (Per anetare te familjes)  |   |   |   |   |   |
| 47 | 021422 | PNS-Kategoria II (Per anetare te familjes) |   |   |   |   |   |
| 48 | 021430 | Pagesat per invalid te lutes               |   |   |   |   |   |
| 49 | 021431 | Pagesat per invalid civil                  |   |   |   |   |   |
| 50 | 021432 | Pagesat per familjet e viktimave te luftes |   |   |   |   |   |
| 51 | 021440 | Pagesat e Perkohshme per Trepçen           |   |   |   |   |   |
| 52 | 030000 | Shpenzimet Kapitale                        | - | - | - | - | - |
| 53 | 030000 | Ndertesat e Banuara                        |   |   |   |   |   |
| 54 | 030001 | Ndërtesat jo te Banuara                    |   |   |   |   |   |
| 55 | 030002 | Strukturat tjera                           |   |   |   |   |   |
| 56 | 030003 | Ndërtimi I Rrugeve                         |   |   |   |   |   |
| 57 | 030004 | Kanalizimi                                 |   |   |   |   |   |
| 58 | 030005 | Ujesjellesi                                |   |   |   |   |   |
| 59 | 030010 | Orendite                                   |   |   |   |   |   |
| 60 | 030011 | Paisjet e TI                               |   |   |   |   |   |
| 61 | 030012 | Paisjet tjera                              |   |   |   |   |   |
| 62 | 030013 | Automjetet për Transport                   |   |   |   |   |   |
| 63 | 030014 | Makineria                                  |   |   |   |   |   |
| 64 | 030015 | Instalimi I Oreve Matese te Ujit           |   |   |   |   |   |
| 65 | 030016 | Kapitalet tjera te vogla                   |   |   |   |   |   |
| 66 | 030020 | Pasuritë e Kultivuara                      |   |   |   |   |   |
| 67 | 030021 | Pasurite e Patundshme                      |   |   |   |   |   |
| 68 | 030100 | Gjerat me Vlere                            |   |   |   |   |   |
| 69 | 030200 | Toka                                       |   |   |   |   |   |
| 70 | 030210 | Pasurite e Patrupezuara jo prodhuese       |   |   |   |   |   |
| 71 | 030220 | Pasurite tjera natyrore                    |   |   |   |   |   |
| 72 | 030310 | Transferet Kapitale-Etnitetet Publike      |   |   |   |   |   |
| 73 | 030320 | Transferet Kapitale-Etnitetet Jopublike    |   |   |   |   |   |

I NËNSHKRUARI NË KËTË MËNYRË E VERTETON SE INFORMATAT QË I PËRMBAN KJO FORMË ËSHTË E PLOTË DHE KORREKTE SI NË KOHEN E DOREZIMIT NË MINISTRINË E EKONOMISE DHE FINANCAVE MËTUTJE, TË GJITHA PROCEDURAT ASHTU SIQ JANË PARAQITUR NË QARKOREN E BUXHETIT JANË PËRCJELLUR DHE KJO KËRKESË ËSHTË APROVUAR NGA AUTORITETI PREJ TË CILIT ËSHTË KËRKUAR. I NËNSHKRUARI NË KËTË MËNYRË QË SHUMA E PARAQITUR PËR VITET NË FJALË TË PËRVETËSOHET NGA KJO ORGANIZATË BUXHETORE NË PËRPUTHSHMËRI ME PROCEDURAT LEGALE

|                                     |      |         |                                                                       |         |      |            |
|-------------------------------------|------|---------|-----------------------------------------------------------------------|---------|------|------------|
| Kryesuesi i Nën njësis së Programit | Emri | Titulli | Zyrtari Kryesor Financiarë ose i Ekzekutivit të Organizatës Buxhetore | Titulli | Data | Nënshkrimi |
|                                     |      |         |                                                                       |         |      |            |









REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;  
Kuvendi i Komunës së Junikut;  
Numër: 02-180/05/25  
Datë: 23.05.2025

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.09.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:


**FTESË**

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Nga:** **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Lënda:** Mbledhja e pestë (05) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Vendi:** Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;  
**Data:** 30.05.2025, ora 10<sup>00</sup>.

**Rendi i ditës:**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit ne komunën e Junikut;
4. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2026/28 të Ministrisë së Financave;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit Komunal të Neprimit për Energji dhe Klimë 2025-2028 për Komunën e Junikut;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për menaxhimin e integruar të mbeturinave (leximi pare);
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
8. Të ndryshme.

# INFORMATË MBI ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË KOMUNËN E JUNIKUT 2025



Të nderuar/a,

Komuna e Junikut, falë pozitës së saj gjeografike, peizazhit të pasur natyror dhe trashëgimisë së pasur kulturore, përfaqëson një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në nivel lokal dhe kombëtar. Duke e konsideruar këtë sektor si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social, gjatë këtij viti janë ndërmarrë hapa konkretë për fuqizimin e ofertës turistike, përmirësimin e infrastrukturës, ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e resurseve dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e aktiviteteve, projekteve dhe planeve të cilat janë realizuar ose janë në proces për vitin 2025 në drejtim të zhvillimit të turizmit në Komunën e Junikut.

## 1. Hapja e Qendrës për Informim Turistik

Më 19 mars 2025, është realizuar me sukses hapja zyrtare e Qendrës për Informim Turistik, një objekt me rëndësi të veçantë për orientimin dhe informimin e vizitorëve që frekuentojnë komunën tonë. Qendra ka për qëllim të jetë pika e parë e kontaktit për turistët, duke ofruar informata për atraksionet natyrore, shtigjet malore, kapacitetet e akomodimit, ngjarjet kulturore dhe aktivitetet që ofrohen në Komunën e Junikut.

Në kuadër të kësaj qendre, tashmë operon edhe Stacioni i Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit të Kosovës, një njësi profesionale e cila funksionon me kapacitet të plotë. Kjo rrit në mënyrë të konsiderueshme sigurinë për turistët, veçanërisht për ata që eksplorojnë zonat alpine dhe shtigjet më të largëta.

## 2. Master Plani për Bjeshkët e Junikut – Planifikim Strategjik për Zhvillim të Qëndrueshëm

Me datë 23 maj 2025, Swisscontact dhe Komuna e Junikut do të organizojnë prezantimin zyrtar të Master Planit për Bjeshkët e Junikut. Ky dokument përfaqëson një platformë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor, duke harmonizuar mbrojtjen e natyrës me zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike.

Ngjarja do të organizohet në formë konference dhe do të bashkojë biznese vendore dhe kombëtare, si dhe investitorë ndërkombëtarë të cilët janë ftuar përmes odave të bizneseve si ajo gjermane, japoneze, amerikane e të tjera. Qëllimi është të nxisim partneritete të reja, të promovojmë potencialin e bjeshkëve dhe të tërheqim investime në sektorin e turizmit malor.

### **3. Ndërtimi i Urat Ndërkombëtare të Bashkëpunimit – Takim me tour-operatorë evropianë**

Në vazhden e diplomacisë turistike, më 15 maj 2025, Komuna e Junikut do të mirëpresë një grup të përzgjedhur tour-operatorësh nga Italia, Franca dhe vende të tjera të Evropës Perëndimore. Takimi do të ketë për qëllim prezantimin e potencialit të komunës në fushën e turizmit të natyrës, aventurës dhe kulturës.

Përmes këtij takimi synohet jo vetëm promovimi i Junikut si destinacion turistik, por edhe ndërtimi i rrjeteve të bashkëpunimit, duke e integruar komunën në itinerare ndërkombëtare dhe duke e futur në paketat e agjencive evropiane të turizmit.

### **4. Festivali “Ditët e Gjeravicës” – Promovimi i Majës më të Lartë të Kosovës**

Me datat 7 dhe 8 qershor 2025, do të organizohet edicioni i radhës i festivalit të njohur “Ditët e Gjeravicës”, një ngjarje që është shndërruar tashmë në traditë për Komunën e Junikut. Festivali përfshin aktivitete të ndryshme si ecje malore, ngjitje, muzikë live dhe promovim të produkteve tradicionale.

Kjo ngjarje jo vetëm që nxit vizita turistike, por edhe krijon mundësi për pjesëmarrje të bizneseve vendore, të cilat përfitojnë nga rritja e frekuentimit dhe konsumi i produkteve lokale gjatë festivalit.

### **5. Projekti “Mirdita – Junik” dhe Festivali “KAH DRITA”**

Në muajin korrik 2025, në kuadër të projektit ndërkomunal “Mirdita – Junik”, do të organizohet festivali “KAH DRITA”, një ngjarje që synon të gërshetojë natyrën me trashëgiminë kulturore. Ky festival do të jetë një platformë për shfaqje artistike, performanca muzikore, tregje artizanale dhe aktivitete në natyrë.

Paralelisht, projekti “Mirdita–Junik” do të sjellë investime kapitale në shtigjet turistike dhe infrastrukturën mbështetëse:

- Shtigjet e Kanionit dhe Gradinës do të rregullohen dhe shenjëzohen sipas standardeve bashkëkohore.
- Përgjatë rrugës Junik – Gropa e Erenikut do të ndërtohen ballkone panoramike, të cilat do të ofrojnë pamje spektakulare dhe do të jenë pika atraktive për turistët dhe vizitorët.

## **6. Digjitalizimi i Qendrës për Informim Turistik – Rritja e Aksesit dhe Informimit**

Gjatë këtij viti është planifikuar të realizohet digjitalizimi i plotë i Qendrës për Informim Turistik, një hap i domosdoshëm për modernizimin e shërbimeve dhe lehtësimin e qasjes në informata për turistët.

Platforma digjitale do të ofrojë informacione në kohë reale për atraksionet turistike, kalendarin e ngjarjeve, akomodimet, shtigjet, hartat dhe shërbimet mbështetëse. Në këtë mënyrë, vizitorët do të kenë mundësi të planifikojnë më mirë qëndrimin e tyre në Junik dhe të eksplorojnë më shumë se vetëm destinacionet kryesore.

## **7. Shtegu “Via Dinarica” – Infrastruktura dhe Festivali Ndërkombëtar**

Një ndër projektet më madhore për vitin 2025 është përfundimi i shenjëzimit dhe hapjes së shtegut Via Dinarica në pjesën e Junikut, me gjatësi prej rreth 34 kilometra. Ky shteg është pjesë e një rruge ndërkombëtare që përshkon tërë Ballkanin dhe lidhet me rrjetin evropian të turizmit të ecjes.

Përfundimi i punimeve është planifikuar për muajin maj 2025, ndërsa në muajin gusht do të mbahet Festivali “Via Dinarica”, një ngjarje që do të sjellë alpinistë, turistë dhe media nga rajoni dhe më gjerë. Qëllimi i festivalit është të promovojë Junikun si pikë kyçe në këtë rrjet ndërkombëtar, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe promovimin ndërkombëtar të komunës.

## **8. Festivali “Dita e Gështenjës” – Trashëgimia Agrobujqësore në Fokus**

Në fund të vitit, si çdo vit, do të organizohet festivali tradicional “Dita e Gështenjës”, një aktivitet që synon të promovojë produktet pyjore dhe bujqësore, në veçanti gështenjën – një simbol i rëndësishëm për ekonominë dhe identitetin lokal të Junikut.

Festivali përfshin panairë të produkteve vendore, aktivitete kulturore dhe shfaqje të traditës dhe vlerave të komunitetit. Kjo ngjarje është gjithashtu një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit rural dhe gastronomik, si dhe për fuqizimin e bujqësisë tradicionale në zonën tonë.

## 9. Rruga Junik – Gjeravicë

Një ndër investimet më të rëndësishme infrastrukturore që pritet të përfundojë brenda vitit 2025 është asfaltimi i rrugës Junik – Gropa e Erenikut. Kjo rrugë, e cila lidh zonën urbane me pjesët më të thella të Bjeshkëve të Erenikut, paraqet një korridor strategjik për zhvillimin e turizmit malor në komunën tonë. Përmes kësaj rruge, vizitorët do të kenë qasje të drejtpërdrejtë dhe të sigurt drejt destinacioneve të njohura për natyrën e virgjër, shtigjet alpine dhe atraksionet e larta të Bjeshkëve të Junikut. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore jo vetëm që do të rrisë ndjeshëm numrin e vizitorëve gjatë tërë vitit, por gjithashtu do të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit aktiv, si ecja malore, eksplorimi i natyrës dhe kampingu. Ky investim është hap kyç për integrimin e potencialit turistik të zonave malore në ofertën e përgjithshme të turizmit të komunës dhe për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal në këto zona.

## 10. Pjesëmarrja në Panaire Ndërkombëtare të Turizmit

Gjatë vitit 2025, Komuna e Junikut ka marrë pjesë aktive në dy panaire të rëndësishme ndërkombëtare të turizmit:

- **Tourism & Travel Show Albania 2025** në Tiranë – ku është prezantuar oferta turistike e komunës me theks në turizmin malor dhe kulturor.
- **ITB Berlin 2025** – panairi më i madh i turizmit në botë, ku Juniku është prezantuar për herë të parë me një platformë profesionale dhe materiale promovuese që kanë tërhequr interesim nga agjenci dhe investitorë ndërkombëtarë.

Kjo pjesëmarrje ka ndihmuar në promovimin e komunës në tregjet ndërkombëtare dhe në krijimin e kontakteve të reja për bashkëpunim dhe zhvillim të mëtejshëm të turizmit.

Duke marrë parasysh aktivitetet dhe projektet e lartpërmendura, është e qartë se turizmi në Junik po ecën drejt një drejtimi të qëndrueshëm, të organizuar dhe gjithëpërfshirës. Me hapa konkrete në infrastrukturë, promovim, siguri dhe bashkëpunim ndërkombëtar, Komuna e Junikut po forcon pozicionin e saj si një destinacion turistik i rëndësishëm në hartën e Kosovës dhe më gjerë.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të vazhdojë të jetë aktive në zbatimin e projekteve dhe planeve strategjike për të maksimizuar përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore që vijnë nga zhvillimi i turizmit.

Me respekt,

z.Jetmir Jasiqi – Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK  
01/Nr. Prot. 2-955/3425  
Nje. Org. 7  
Nr. i faq. 1  
Data 14.05.2025

|                        |                                                                                                                              |
|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 14.05.2025                                                                                                                   |
| PËR/ZA/TO:             | z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal                                                                           |
| PËRMES/PREKO/TITROUGH: | z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës                                                                                           |
| NGA/OD/FROM:           | znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa                                                                      |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit Komunal informatën rreth Qarkores Buxhetore 2026/01 |

I nderuar,

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (I.MFPP) nr: 03/L.-048 neni 20, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr: 03/L.-040 neni 40 alinea 40.2 pika nën b), si dhe duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2026/01 për Komunitat të nisur nga Ministria e Financave, kërkojmë nga ju që të shtohet në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit Komunal informata rreth Qarkores Buxhetore 2026/01.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                        |                                                                                 |
|------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 19.05.2025                                                                      |
| PËR/ZA/TO:             | Kryetarin e Komunës<br>Kryesuesin e Kuvendit<br>Drejtorët e Drejtorive Komunale |
| NGA/OD/FROM:           | znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa                        |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | NJOFTIM                                                                         |



Të nderuar!

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr 03/L-048, neni 60, Ligjin për Vetëqeverisje lokale ( Ligji Nr:03/ L-040) dhe Statutin e Komunës, pas pranimit të Qarkores Buxhetore 2026/01 në formë elektronike nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të datës 15.05.2025, Komuna ka për obligim fillimin e Procedurave të planifikimit të Buxhetit për periudhën 2026-2028 në përputhje me limitet buxhetore të përcaktuara në Qarkore buxhetore e cila bazohet në KASH-in (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve) 2026-2028.

Përmes këtij njoftimi keni obligim që të hartoni planifikimet për Programin tuaj përkatës dhe ti dorëzoni në e-mail dhe në kopje fizike tek drejtoria për Buxhet dhe Financa deri me datë 30.05.2025.

Në formë elektronike do ti keni të bashkangjitura Qarkoren Buxhetore komunale 2026/01 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Qarkoren e brendshme komunale # 2026-01 dhe formularët e nevojshëm për paraqitjen e propozimeve nga ana juaj.

Bashkangjitur në email:

- A) Deklarata për misionin dhe performansën sipas Drejtorive/ Programeve
- B) Qarkorja Buxhetore nr. 2026/01 për Komuna (MFPT)
- C) Qarkorja e brendshme buxhetore komunale #2026/01
- D) Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027 (e vitit të kaluar) ku mund të mbështeteni për ndryshimet që planifikoni të bëni për vitet 2026-2028.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA JUNIK  
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02-04/25                                       |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 30.04.2025                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së katërt (04) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 30.04.2025, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti nënkryetarin e Komunës së Junikut z.Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët e Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit, më pas konstatoi se në mbledhje marin pjesë te 11 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leonora Shehu AD,znj.Vjollca Qestaj-DBF,z.Jetmir Jasiqi-DEZH, z.Zenun Shala DUKM, z.Fatos Shala-DSHMS, z.Demokrat Ganiqaj-DSHPMSI.

#### Anëtarët prezent

- |                                       |                                      |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK  | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK       | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK     |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK      | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK    |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK          | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV     |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV         |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK       | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV           |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK    |                                      |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK         |                                      |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK   |                                      |

### **Rendi i ditës i paraparë**

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për Përiudhën e parë Janar-Mars 2025,
4. Informatë lidhur me gjendjen e Arsimit në Komunën e Junikut,
5. Nxjerrja e vendimt për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt rregullores për taksa,tarifa dhe ngarkesa, për vitin 2026,
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,
7. Të Ndryshme

z.Shpejtim Gacaferi, para se te votohet rendi i ditës i paraparë per mbledhjem e sotit, është një kërkesë nga Drejtoria e Urbanizimit Kadastër dhe Mjedis, që si pikë e rendi të ditës të hynë Miratimi i Planit Zhvillimor (PZHK) 2025- 2033 për më shumë ja kaloj fjalën propozuaesit.

z.Zenun Shala, përshëndetje për të gjithë, ne me në fund e kemi marrë vijën e gjelbërt nga ministria për planifikim hapsinorë, qe te aprovohet PZHK-ja, na ka ardhur me vonesë, duke e marrë parasysh thirrjen e kësaj mbledhje, dhe ne kemi menduar që këtë pikë ta qesin edhe në mbledhje te jashtëzakonshme, mirëpo meqë ka pasur kohë të bollshme qe ta shqyrtojnë anetare e kuvendit ne kemi menduar qe ta kemi si pike te rendit te ditës per mbledhjen e sotit.

Rethe rendit te ditës

z.Leonard Llojuni, përshëndetje per te gjithë, ne si grup i AAK\_se dhe unë personalisht e kemi marrë me vonesë kërkesen për miratim te PZHK\_se, kjo si pikë nuk ka kaluar as ne mbledhjen e KPF\_se, dhe te premten disave prej anëtarëve te kuvendit jau keni percjellur edhe me CD e disave vetëm në e-mail, mua personalisht më ka ardhur materiali vetëm në e-mail, Plani Zhvillimor Komunal shte një dokument shumë strategjik për Komunën e Junikut, i cili e përcakton zhvillimin e komunës për tetë vitet e ardhshme qe i bie deri ne vitin 2033, dhe me aq sa kam arritur ta lexojë këtë plan, plani është shumë selektiv, i përfshinë vetëm disa interesa të disa individëve, dhe përkundër që në diskutim publik ka pasur kërkesa nga qytetarët e kësaj komune, ato kërkesa nuk janë te përfshira në këtë plan zhvillimor, andaj si e tillë ky plani zhvillimor është selektiv dhe nuk i përfshinë te gjitha kërkesat e te gjithë qytetarëve të Komunës se Junikut, andaj unë kerkoj që kjo pikë te shtyhet për një muaj dhe të na vije si shqyrtim për mbledhjen e radhës, përndryshe ne si grup i AAK\_se nuk marim pjesë në votim të rendit të ditës.

z.Shpejtim Gacaferi, e qes në votim rendin e ditës kush është për? për janë 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

z.Shpejtim Gacaferi, pikat e rendit te ditës te propozuar per mbledhjen e sotit:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për Përiudhën e parë Janar-Mars 2025,
4. Informatë lidhur me gjendjen e Arsimit në Komunën e Junikut,
5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësimit-ndryshimeve të projekt rregullores për taksa,tarif dhe ngarkesa për vitin 2026,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimore Komunal për vitin 2025-2033
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,
8. Te ndryshme

z.Zenel Maloku, përshëndetje për të gjithë, para se të fillojmë me pikat e tjera të rendit të ditës kryesues unë kërkoj që mbledhja e fundit që është ndërprerë, duhet që fillimisht ajo mbledhje të përfundojë dhe më pas të vazhdojmë me këtë mbledhje.

z.Shpejtim Gacaferi,mbledhja është ndërprerë në piken të ndryshme, dhe kjo pikë nuk është pikë vendim marrëse dhe për këtë nuk kanë bërë thirrje për vazhdimin e mbledhjes, këtë e përcakton edhe rregullorja e punës së kuvendit.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

Për këtë mbledhje munguan : z.Alfred Gaxherri-LDK, z.Lulzim Gacaferi-LVV, znj.Eliza Pepshi-LVV dhe Xhemë Tofaj-LVV. Në fillim të mbledhjes prezent ishin 11 anëtarë të kuvendit, tani kemi prezent 8 anëtarë të kuvendit.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Zenel Maloku, unë kërkoj nga procembajtsi që të këtë kujdes mos të lejohet fjalitë përgjysmë por të shkruaj të plotë, psh në faqen dy të emri im ka gabim po ashtu ka gabime edhe në faqet tjera dhe unë kërkoj që të kenë kujdes dhe procesverbali të na vijë i plotë.

z.Besart Tofaj, përshëndetje për të gjithë, në mbledhjen e fundit unë nga shefi i grupit të AAK-se jam quajtur mashtrues dhe për të nisur procedurat gjyqësore kërkoj që kjo fjalë të referohet ashtu si është më e saktë drejtuar, nuk po kërkoj diçka që nuk ka ndodhur por të shënohet ashtu siç ka ndodhur.

z.Shpejtim Gacaferi, unë e kam në votim procesverbalin me këto vërejtje, kush është për? për 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoj se procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua me vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për Përiudhën e parë Janar-Mars 2025,

Raportin financiar te komunës se Junikut per periudhën Janar-Mars 2025 e beri znj.Vjollca Qestaj- drejtoresh ne DBF e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë dhe me pas e arsyetoi para anetareve te Kuvendit Raportin financiar per periudhën Janar-Mars 2025.

#### 4. Informatë lidhur me gjendjen e Arsimit në Komunën e Junikut,

Informaten mbi gjendjen e Arsimit ne komune e Junikut e beriz.Xhavit Velijaj-Drejtor në DAKRS, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë, më pas i informoj anëtarët e kuvendit mbi gjendjen e Arsimit në Komunën e Junikut.

znj.Rajmonda Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, ne për gjendjen e arsimit në komunën e Junikut e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF\_se, dhe më ka shqetësuar fakti te vlerësimi, nëse deri ne klasën e gjashtë vlersimi është 4.2, ndërsa nga 6-9 vlersimi është 2.9, kjo rënje është drastike dhe diku ka ngecje.

z.Zenel Maloku, edhe për mua është shqetësuese kjo që u tha nga parafolësja, dhe kisha dashtë një shpjegim nga drejtori se pse është kjo ramje drastike e vlerësimit?

z.Xhavit Velijaj, edhe në mbledhjen e KPF\_se e kam dhenë një sqarim lidhur me këtë ramje të vlerësimit, dhe unë për këtë çështje kam berë pyetje edhe ne drejtorinë e shkollës, dhe pergjigjen se kam mare nga drejtori është se kriteret e vlerësimit prej klases së gjashtë deri ne klasën e nëntë janë më të forta dhe kjo ka ndikuar që të këtë këtë ramje, mirëpo ndikim tjetër është edhe ndryshimi që behet nga nje mësues në shumë mësues, edhe nga kjo kemi konstatuar se ka ndikim në ramje te notës, mirepo ne jemi duke punuar në vazhdimësi që t krijomë mundësi që mësimedhënja të jetë në nivel sa me të lartë.

znj. Rajmonda Krasniqi, për këto arsye qe u than edhe e ngrita si çështje këtë ramje drastike të vlersimit me nota, nga niveli fillorë ne nivelin fillore te lartë pra nga 1-5 me notën 4.2 dhe nga 6-9 me notën 2.9, dhe nëse konstatohet se ka kriteret te forta për nivelin nga 6-9, a i bije që për nivelin 1-5 kriteret kanë qenë më të buta.

z.Zenel Maloku, u përmenden kriteret, unë e di se kriteret duhen te jenë te njëjtë për të gjithë nga klasa e parë dheri ne fund, e jo te thuhet se ka kriteret të tjera për 1-5 e nga 6-9 kriteret tjera, dhe ne kete kontest drejtori duhet te punoje me shume qe kriteret te jene te njëjta per te gjitha nivelet.

#### 5. Nxjerrja e vendimt për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt rregullores për taksa,tarifa dhe ngarkesa për vitin 2026,

Sqarimin dhe arsyetimin e fillimit të plotësim ndryshimeve të projekt rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa e beri znj.Vjollca Qestaj- drejtoreshë në DBF, e cila më pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anetareve të kuvendit plotësim ndryshimin e projekt rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2026.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes në votim fillimin e plotësim ndryshimeve të projekt rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2026, kush është për? për 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se fillimi i plotësin ndryshimit te projekt rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2026 u miratua.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal për vitin 2025-2033  
Aryetimi per PZHK-ne u dhan ne fillim të mbledhjes.

z.Zenel Maloku, sa i përket kësaj pike unë nuk kam marrë material, dhe kjo nuk është mirë nga ana e juve, materiali duhet të më vije me kohë, por edhe përkundër kësaj unë kërkoj që plani zhvillimor komunal të jetë i barabartë për të gjithë banorët e komunës së Junikut jo për dikë të jetë i favorshëm e për dikë jo i favoreshëm, unë do të jam pro planit zhvillimor komunal për më këtë që po e them është se në këtë plan zhvillimor keni edhe mungesa.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, ne e dimë rëndësinë e planit zhvillimor komunal, dhe do ishte e udhës që të paktën ta sqarojmë më shumë, te diskutojmë dhe te parashtrojmë pyetje me shumë dhe ti shtjellojmë të gjitha çështjet këtu në këtë kuvend e jo të flasim më pastaj fjalë të rrugëve, unë e pata një pyetje për drejtorin, kërkesat e qytetarëve që janë parashtruar gjatë dëgjimeve publike, a mundemi me i dite procedurat për kërkesat që janë refuzuar, a janë refuzuar nga ministria apo nga komuna?

z.Zenun Shala, te gjitha kërkesat i keni në cede dhe aty e keni edhe refuzimin e tyre dhe arsyen e refuzimit.

z.Zenel Maloku, a mundesh me na shpjegu me shume se pse janë refuzuar kërkesat.

z.Zenun Shala, tokat që janë te klasës së dytë dhe të tretë ministria nuk i ka lejuar që këto toka të jenë për panele diellore, ndërsa tokat e klasës së pestë janë lejuar për panele diellore.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes në votim PZHK:2025-2033, kush është për? për 8 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 u miratua.

7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit,

z.Zenel Maloku, pse kryetari i Komunes nuk po mere pjese ne mbledhjet e kuvendit , kjo është mbledhja e tretë me radhe që kryetari i komunës nuk mere pjese, çka është në pyetje.

z.Besar Tofaj, kryetari i Komunës sot gjindet ne Prishtinë për pranimin e grandit të perfomancës, pasi që siç e dini Komuna e Junikut është përfitues në këtë grand.

z.Zenel Maloku, unë kërkoj nga ju kryesues që kur ta dini se kryetari i komunës nuk mund të merrë pjesë ne mbledhjen e kuvendit, ta ndrroni datën e mbajtjes së mbledhjes dhe ta caktoni në ditën kur kryetari i komunës mund te marrë pjesë në mbledhje.

8. Të Ndryshme.

z.Zenel Maloku, çështja ka të bejë me mbledhjen e fundit që është ndërprerë për shkaqe të kuoromit, dhe unë i drejtohem drejtorit të Arsimit, me gjithë respektin që e kam për atë, me ja dhanë një porosi edhe pse nuk jamë këshilltar i tij, po ashtu as shkollën e tij nuk e kamë, e

porosia është kjo, drejtori i arsimit është ka e rritë një kopsht me lule dhe është ka kujdeset për të shume mirë, është duke rritur lula në Junik dhe dhashtë zoti behen lule të Kosovës, por e kisha porositur edhe kryetarin e komunës mos ti krahasojë njëjtë si lulet ashtu edhe morrizat, sepse kan dallim te madh, dhe unë kamë rrespekt te madh për lula te Junikut, dhe e lusë drejtorin që të mos bëhet avokat i së keqes, gjerat e këqija që kanë ndodhur në Junik nuk ju kam thenë unë që ti bëjnë, i kanë berë vet duke u nisur nga drejtorët por edhe nga zyrtarët Komunal, kanë berë gjera te qqija sa qe une e ni veten shume keq, dhe ti ne mbledhjen e fundit me ke kritikuar dhe me kritikuar gabimisht andaj prap po te them mëru me lula te Junikut dhe mos u be avokat i se keqes.

z.Besart Tofaj, secili drejtor eshte i thirrur me e mbrojte pune e vete, per çka eshte edhe i emëruara ne ate pozite, kështu qe drejtori nuk e ka ofenduar askënd, por edhe nëse e ka ofenduar dike, une kerkoje falje ne emër te drejtori por edhe ne emër te gjithë stafit, por per këto qeshtje mundemi me pase mendime te ndryshme secili prej nesh, andaj mos u merni me bo politik me çdo qeshtje, ne këtu nuk jemi polici as gjykat nëse tu ka ber diçka e pa drejtë mundeni me ju drejtuar këtyre instancave kudër kryetarit dhe secilit zyrtarë komunal.

z.Xhavit Velijaj, është shumë e quditshme menyra e komunikimit sepse nuk eshte ne nivel te duhur sidomos per kete kuvend, nje debat i tille, edhe ne mbledhjen e fundit une nuk e kam mbrojtur askënd vetëm e kam shprehur mendimin tim, sepse te thuhet se ktu eshte gjithçka zi, normal se atëherë une kam te drejte te jepi nje mendim, dhe une edhe tash po shoh se doni ta shëndroni kuvendin në cirk, ne fymje ,sharje , ne si dektor jemi ktu që të ju informojmë për atë drejtori që jemi caktuar siç edhe ndodhi sot se ju informova, nëse keni diçka mundeni me ju drejtuar instancave të drejtësisë, dhe jo të ofendoni apo të shani këtu.

z.Shpejtim Gacaferi e shpalli te mbyllur mbledhjen e Prillit 2025

Procesmbajtësi:  
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:  
z. Shpejtim Gacaferi



|        |                                                                                                                                                                                         |
|--------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|        | <b>QARKORE E BRENDSHME BUXHETORE KOMUNALE #2026/01</b>                                                                                                                                  |
| Për:   | Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, të gjithë Drejtorët e Drejtorive (Programeve Buxhetore) të KK-Junik                                                                         |
| Nga:   | znj. Vjollca Qestaj - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa                                                                                                                                |
| Data:  | 19.05.2025                                                                                                                                                                              |
| Lënda: | <b>Përgatitja e materialeve buxhetore - Propozim Buxhetit Komunal sipas Drejtorive (Programeve Buxhetore) për periudhën 2026-2028, sipas Qarkores Buxhetore nr. 2026/01 për Komuna.</b> |

Kjo Qarkore e brendshme komunale #2026/01 do të ju ofroj udhëzime për përgatitjen e Propozim Buxhetit për Drejtoritë komunale, pasi që na nevojiten informatat për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026/2028.

Me Qarkoren Buxhetore 2026/01 për Komunat dërguar nga Ministria e Financave, Punës dhe transfereve ju njoftojmë për zhvillimin e procesit buxhetor komunal në pajtim me procedurat dhe kalendarin e përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Komisioni i Grandeve pranë MFPT ka aprovuar grandet qeveritare për financimin komunal në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet: 2026-2028, si dhe parimet, kriteret dhe formulat e përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, andaj referojuni asaj qarkoreje si dhe KASH-it të miratuar.

- Kërkojmë nga të gjithë Drejtorët e Drejtorive (Programeve) buxhetore që deri me datë: 30.05.2025, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të paraqesin Kërkesat e tyre buxhetore për vitet: 2026-2028, konform limiteve të Qarkores Buxhetore nr. 2026/01, për të gjitha kategoritë buxhetore të shpenzimeve siç janë: Paga&Mëditjet, Mallra dhe shërbime, Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe Transferet si dhe Shpenzimet kapitale, (Të ndryshohen projektet nëse është nevoja sipas prioritetëve, të shtohen projektet nëse keni plane, duke ju referuar listës së projekteve 2025/2027 të bashkangjitur në email) si dhe Drejtoria që inkason të hyra të paraqes parashikimin e të hyrave vetanake.
- Po ashtu duhet të paraqitni numrin e punëtorëve të Drejtorisë (Programit) tuaj buxhetor si dhe koeficientet e pagave (aktual) që ekzistojnë me Buxhetin e vitit 2025 duke e shtuar vetëm një vit te përvojës se punës për vitin e ardhshëm.
- Grandi i Përgjithshëm për Komunën e Junikut për vitin 2026 sipas qarkores buxhetore 2026/01 është parashikuar të jetë 1,182,544.00€ që është i njëjtë krahasuar me vitin e kaluar, andaj kërkohet nga ne që ti kemi edhe planifikimet sa më prioritare për shkak të limiteve buxhetore të dërguara nga qeveria.
- Grandi specifik për Arsim për komunën e Junikut për vitin 2026 sipas qarkores buxhetore 2026/01 është parashikuar të jetë 673,383.00€ që ka një rritje prej 94,363.00€ krahasuar me vitin e kaluar.
- Grandi specifik për shëndetësi për komunën e Junikut për vitin 2026 sipas qarkores buxhetore 2026/01 është parashikuar të jetë 487,384.00€, që ka një rritje në vlerë prej 113,747.00€ krahasuar me vitin e kaluar.
- Të hyrat vetanake të parashikuara janë 195,301.00€, që ka një zbritje në vlerë prej 9,641.00€ krahasuar me vitin të kaluar.
- Totali i buxhetit për komunën e Junikut për vitin 2026 sipas qarkores buxhetore 2026/01 është parashikuar të jetë 2,538,612.00€ që ka një rritje prej 198,469.00€ krahasuar me totalin e buxhetit të vitit të kaluar duke ju referuar qarkores së parë buxhetore 2026/01 ta kemi parasysh.
- Për projeksionet e viteve 2026-2028 referojuni qarkores buxhetore 2026/01, dhe bëjeni parashikimin për KAB-in komunal sepse duhet të bëhet planifikimi për tri vite.

Bashkangjitur:

- A) Deklarata për misionin dhe performansën sipas Drejtorive/ Programeve
- B) Qarkorja Buxhetore nr. 2026/01 për Komuna
- C) Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 – të rishikohet Lista e projekteve 2025-2027 dhe propozimet për 2026 ti bashkangjiten listës në formularin A, nga ana e Drejtorive, në rast se keni projekte të reja që nuk janë pjesë e KAB-it 2025-2027.

**Vërejtje:**

Sqarime më të hollësishme rreth plotësimit të Kërkesave buxhetore- formularëve, mund të merren në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe nga Zyrtari Kryesor Financiar.

Bashkangjitur në ANEKS keni edhe tabelat për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të cilat duhet të plotësohen në formularin A dhe të jenë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

**ANEKS 1**  
**Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor**

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse  
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

| Viti                 | Numri total i stafit | Numri total i stafit që janë gra | Numri total i stafit që janë burra | Paga dhe mëditje/Shuma për gra | Paga dhe mëditje/Shuma për burra |
|----------------------|----------------------|----------------------------------|------------------------------------|--------------------------------|----------------------------------|
| 2023                 |                      |                                  |                                    |                                |                                  |
| 2024                 |                      |                                  |                                    |                                |                                  |
| 2025                 |                      |                                  |                                    |                                |                                  |
| Planifikimi për 2026 |                      |                                  |                                    |                                |                                  |

Tabela 2 Planifikimi për vitin 2026 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore  
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

| Niveli i pagave | Numri total i stafit në këtë nivel të pagave | Numri i burrave në këtë nivel | Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel | Numri i grave në këtë nivel. | Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel |
|-----------------|----------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------------|
| 201-400         |                                              |                               |                                           |                              |                                         |
| 401-600         |                                              |                               |                                           |                              |                                         |
| 600+            |                                              |                               |                                           |                              |                                         |

**Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)**

[Emri i Institucionit/Ministritsë/Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

| Viti                 | Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar | Numri total i përfituesve | Numri i përfituesve gra | Numri i Përfituesve burra | Buxheti për gra | Buxheti për burra |
|----------------------|---------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------|---------------------------|-----------------|-------------------|
| 2023                 |                                                   |                           |                         |                           |                 |                   |
| 2024                 |                                                   |                           |                         |                           |                 |                   |
| 2025                 |                                                   |                           |                         |                           |                 |                   |
| Planifikimi për 2026 |                                                   |                           |                         |                           |                 |                   |

## ANEKSI 2

### INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË PROGRAMIT BUXHETOR

Organizata buxhetore: KOMUNA JUNIK

| 636 KOMUNA E JUNIKUT |               |                   |
|----------------------|---------------|-------------------|
| Objektivi 1          | Treguesi bazë | Treguesi i synuar |
|                      |               |                   |
| Aktivitetet:         |               |                   |
|                      |               |                   |
|                      |               |                   |
|                      |               |                   |
|                      |               |                   |
| Objektivi 2          | Treguesi bazë | Treguesi i synuar |
|                      |               |                   |
| Aktivitetet:         |               |                   |
|                      |               |                   |
|                      |               |                   |
|                      |               |                   |